



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 496 Akti**

**V E N D I M**  
**(i ndërmjetëm)**  
**Nr. 5, datë 20.7.2022**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Ester Arapi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 18.7.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim çështjen e subjektit të rivlerësimit Jurida Bajraktari, me detyrë ndihmëse ligjore, dhe

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Znj. Jurida Bajraktari, aktualisht, me detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Jurida Bajraktari do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Valbona Sanxhaktari.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.6.2022 u caktua kryesuese komisionere Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Jurida Bajraktari.
5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Jurida Bajraktari nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 27.6.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht, mbështetur në tri kriteret e vlerësimit, për subjektin Jurida Bajraktari, si dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni me anë të postës elektronike të datës 27.6.2022.

9. Në datën 14.7.2022, subjekti i rivlerësimit dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtime në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe paraqiti prova dhe dokumentacion mbështetës.

10. Pas administrimit të parashtimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 18.7.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermekova.

12. Subjekti i rivlerësimit Jurida Bajraktari është paraqitur në seancën dëgjimore me përfaqësuese ligjore, av. R.Z, anëtare e Dhomës së Avokatisë me licencë nr. \*\*\*, e cila ka shpjeguar në vijim lidhur me prapësimet e subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Trupi gjykues i Komisionit i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të prezantojë personalisht qëndrimin e saj lidhur me konstatimet për vlerësimin profesional, si dhe përgjigjen e saj ndaj thirrjes së bërë për vendin e punës së ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë gjithë dokumentacionin e administruar në Komision.

15. Në këtë vendim do të trajtohet vetëm vlerësimi në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të subjektit Jurida Bajraktari, bazuar në nenin E, si dhe në pikën 2, të nenit E, të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

16. Në lidhje me dy kriteret e tjera Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar, pasi subjekti të ketë përfunduar programin e trajnimit njëvjeçar për ndihmës ligjor, pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e saj.

#### **IV. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**17.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

**18.** Në mbështetje të pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndihmësit ligjorë pranë Gjykatave Administrative vlerësohen bazuar në: (a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe (b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

#### **Lidhur me relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura**

**19. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit** – subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tri dokumente, ndër të cilat një relacion, një vendim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe një draft vendimi përfundimtar. Të tri këto dokumente i përkasin vitit 2016.

**20.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, në raportin që i ka përcjellë Komisionit, ka konkluduar se relacionet janë më tepër në kuptimin e një përshkrimi të vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë dhe parashtrimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse. Nuk ka mendim konkret të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes.

**21. Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short** – çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë 15.1.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.B, kundër të paditurve Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit Gjirokastër, person i tretë Prokuroria e Rrethit Gjirokastër, me objekt “Kompensimin për burgim të padrejtë për periudhën 983 ditë”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.1.2017.

**21.1** Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë 4.3.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës R.V, kundër të paditurit Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Durrës, me objekt “Detyrimin për dëmshpërblim për largim nga puna”, përfunduar Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.5.2017.

**21.2** Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë 22.4.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse S.P, etj., kundër të paditurve Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me objekt “Ndryshimin pjesërisht të aktit administrativ, vendimit nr. \*\*\*, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave për vlerën e shpronësimit në emër të paditësit”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.3.2018.

**21.3** Çështja administrative me nr. \*\*\* akti, datë 5.5.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse B.G, kundër të paditurit Instituti i Shëndetit Publik, me objekt “Shfuqizimin e Urdhrit nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2014, të Institutit të Shëndetit Publik. Marrjen e masës së sigurimit të padisë e pezullimin e zbatimit të urdhrit”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.9.2017.

**21.4** Çështja administrative me nr. \*\*\* akti, datë 13.5.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k., kundër të paditurit Dega e Doganës Vlorë, me objekt “Kthimin e shumës 3.491.036 lekë, për pagesë të padetyruar dhe begatim pa shkak”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.9.2017.

**22.** Konstatohet se në pesë dokumentet e mësipërme nuk ka ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga ndihmësja ligjore Jurida Bajraktari.

**23.** Komisioni, pas verifikimit të raportit të përgatitur nga KLGJ-ja dhe shqyrtimit të tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short konstatoi se:

- Lidhur me njohuritë ligjore, në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk pasqyrohet ndonjë mendim konkret i subjektit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Në pesë dosjet e vëzhguara nuk rezulton asnjë akt i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit, që të mund të vlerësohet aspekti i njohurive ligjore, aftësia për të interpretuar ligjin apo për të identifikuar konfliktin e normave.

- Lidhur me arsyetimin ligjor, në tri dokumentet ligjore është konstatuar se ato janë akte formale dhe përmbajnë strukturën e detyrueshme ligjore. Mirëpo, në përmbajtje të tyre ato nuk kanë asnjë argument ligjor mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe nuk tregojnë mendimin, sugjerimin apo rekomandimin e ndihmësit ligjor.

Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka asnjë dokument ligjor të përgatitur nga subjekti, për këtë arsye aftësia për arsyetimin ligjor nuk mund të konfirmohet as nga pesë dosjet e vëzhguara.

- Lidhur me aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e saj, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të gjyqtarit pranë të cilit është e emëruar ndihmësja ligjore.

- Lidhur me aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore, në pesë dosjet e vëzhguara nuk mund të nxirret asnjë e dhënë lidhur me aftësinë për të kryer procedurën gjyqësore të ndihmësës ligjore, pasi nuk ka të administruar në to asnjë akt të përgatitur sipas parashikimeve të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012 paragrafët 1 dhe 2.

- Lidhur me aftësinë për të administruar dosjet, në pesë dosjet e përzgjedhura me short nuk ka të administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Jurida Bajraktari.

**24.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti konstatohet se ato nuk kanë datë përpilimi dhe janë nënshkruar vetëm në fund nga ndihmësi ligjor me rekuizitën “konceptoi”. Dokumentet tregojnë emrin e gjyqtarës, por nuk mbajnë nënshkrimin e saj. Gjithashtu edhe formulari i vetëvlerësimit profesional nuk është i plotësuar rregullisht. Ajo ka nënshkruar vetëm në faqen e fundit të tij (faqe 8) dhe jo në faqet e tjera më parë.

**25.** Në vijim të prapësimeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se ka kryer të gjitha detyrat e caktuara nga gjyqtarja, pranë së cilës ka ushtruar detyrën, dhe se asnjëherë nuk i është kërkuar prej saj dhënia e ndonjë mendimi konkret lidhur me zgjidhjen e çështjes.

**25.1** Në çmim të dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, rezulton se ajo është përpjekur të justifikohet me faktin se ka bërë aq sa i ka kërkuar gjyqtarja, por ky justifikim nuk mund të mbulojë mungesën e arsyetimit ligjor në dokumente. Duket sikur subjekti ka kryer punën e një stenografeje dhe jo të ndihmësës ligjore, që në bazë të përshkrimit të punës duhet të kryejë këto detyra.

**25.2** Për sa i përket mosadministrimit në pesë dosjet e përzgjedhura me short të dokumenteve të përgatitura nga ndihmësi ligjor, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se çështjet e punuara nga ndihmësi ligjor përgatiteshin paraprakisht përpara se ato të shpalleshin për gjykim dhe e gjithë kjo procedurë e kryer nga ndihmësi ligjor nuk rezulton të jetë plotësuar me ndonjë akt nënligjor apo me ndonjë rregullore të brendshme nga ana e gjykatës, si pasojë e natyrës së ndihmësit dhe vakumit ligjor të sjellë nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**26.** Komisioni vlerëson se aftësitë profesionale të subjektit mbështeten në analizimin e projektakteve të hartuara prej saj në çmuarje të burimeve të rivlerësimit sipas nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Komisioni konstaton se tri dokumentet ligjore janë akte formale dhe nga ana përmbajtësore nuk paraqesin të dhëna mbi aftësitë profesionale të subjektit lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe nuk tregojnë mendime/sugjerime/rekomandime të dhënë nga ndihmësi ligjor për zgjidhjen e çështjes.

**27.** Në rrethanat kur nga vlerësimi i raportit të përgatitur nga KLGJ-ja për subjektin e rivlerësimit Komisioni ka pasur vështirësi të arrijë në një konkluzion mbi aftësitë personale dhe angazhimin profesional të saj i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumente ligjore (5-10 relacione) të përgatitura prej saj gjatë ushtrimit të detyrës.

**28.** Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit 9 akte dhe nga vlerësimi i tyre rezulton se ato janë dokumente formale dhe në përmbajtje nuk reflektojnë tregues mbi aftësinë për arsyetimin ligjor e gjykim të drejtë, sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2, neni 6, i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**29.** Trupi gjykues i Komisionit arrin në konkluzionin se nga vlerësimi i raportit të përgatitur nga KLGJ-ja për subjektin e rivlerësimit, shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, dukshëm subjekti nuk ka reflektuar qartësi në arsyetim, madje në shumë raste ai mungon tërësisht, çka krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit, në pozicionin e ndihmësit ligjor, nuk arrin nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale si në aspektin e njohurive të saj ligjore apo aftësive profesionale. Në materialet e përgatitura prej saj nuk identifikohen tregues të tillë si, aftësia për të interpretuar ligjin, apo identifikuar konfliktin e normave apo aftësia për të analizuar jurisprudencën.

**30.** Në vijim të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ajo ka sjellë edhe disa relacione të përgatitura prej saj në vijim të punës si ndihmëse ligjore. Këto dokumente/materiale të përgatitura prej saj pasqyrojnë të njëjtën situatë faktike të rezultuar gjatë hetimit, ku dukshëm subjekti ka reflektuar mangësi në arsyetim apo njohuritë ligjore dhe aftësinë për të identifikuar konfliktin e normave dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.

**31.** Trupi gjykues i Komisionit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mangësi në arsyetimin ligjor dhe në aftësinë për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim. Evidentohen mangësi në rolin e saj si ndihmëse ligjore dhe në aftësinë për të përmbushur detyrat sipas përcaktimeve ligjore për pozicionin e ndihmësit ligjor.

### **Lidhur me rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës**

**32.** Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, ka vendosur në dispozicion të Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në pikën 4, të nenit 179/b<sup>1</sup>, të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42<sup>2</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale, subjekti ka fituar 44 pikë nga 100 pikë në total, ndërsa në fazën e dytë subjekti ka fituar 132 pikë nga 200 pikë në total.

<sup>1</sup>Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

<sup>2</sup>Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: (a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura, dhe (b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

**32.1** Në mbështetje të nenit 165<sup>3</sup>, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit nuk bën pjesë te subjektet që kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe nuk është kualifikuar për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, pasi rezultoi se ka fituar 44 pikë (nga 60 pikë që nevojiteshin për t’u kualifikuar).

**32.2** Duke qenë se testi në Shkollën e Magjistraturës është një kriter vlerësimi, në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit Jurida Bajraktari, Komisioni vlerëson se ajo ka përfituar një vlerësim në këtë test.

**33.** Komisioni ka hetuar mbi përvojën profesionale të subjektit të rivlerësimit, aftësitë profesionale dhe eksperiencën e znj. Jurida Bajraktari dhe plotësimin prej saj të përvojës profesionale të kërkuar për ushtrimin e detyrës së ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky verifikim është kryer në kuadër të disa të dhënave të mbledhura gjatë hetimit. Nga verifikimi ka rezultuar se:

- Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për KLGJ-në, në periudhën gusht 2010 - dhjetor 2011 ajo figuron e punësuar juriste në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në periudhën janar 2012 – mars 2016 ka deklaruar periudhë papunësie për arsye shëndetësore, ndërsa në periudhën 14.4.2016 deri aktualisht, znj. Jurida Bajraktari ushtron detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

- Sipas të dhënave të mbledhura nga hetimi administrativ ka rezultuar se znj. Jurida Bajraktari ka qenë e punësuar në institucione të ndryshme private dhe publike në Kosovë dhe Shqipëri në periudhat: (i) 5.9.2004 - 30.4.2005, shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*” sh.a., Prishtinë, Kosovë; (ii) 1.3.2006 - 31.3.2006 IEPV nr. \*\*\*, Burgu \*\*\*, \*\*\*; (iii) 1.6.2006 - 30.6.2007 e punësuar te shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*” sh.a., Prishtinë, Kosovë; (iv) 1.7.2007 – 15.9.2009 sekretare në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (v) 26.11.2009 - 20.4.2010 \*\*\*; (vi) 1.8.2010 - 31.10.2010 e punësuar te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë; (vii) 1.11.2010 - 30.11.2011 periudhë leje lindje, DRSSH Tiranë; (viii) 15.4.2016 e punësuar ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit.

**33.1** Në përgjigje të pyetësorit të datës 1.11.2021, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për periudhën kohore 2011 – 2016 ka punuar vullnetarisht në \*\*\* në dhënien e asistencës juridike, pa pagesë.

**33.2** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë e punësuar vetëm për një periudhë rreth 3 vjet e gjysmë për të cilat janë derdhur kontributet shoqërore.

**34.** Në bazë të nenit 6/3 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, zgjidhet ndihmës ligjor në Gjykatën e Apelit shtetasi shqiptar që përmbush kushtin e përvojës në punë:

*“ç) të ketë përvojë profesionale si jurist në organet e sistemit të drejtësisë, në funksione publike në administratën e Kuvendit, administratën e institucionit të Presidentit, aparatit e Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, në Prokurori, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, si më poshtë:*

*ii) mbi 7 vjet përvojë pune për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatën e apelit”.*

**35.** Nga hetimi administrativ i kryer për shkak të procesit të rivlerësimit, si dhe verifikimi i dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit për Komisionin, duket se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari nuk përmbush kushtin e përvojës në punë për të aplikuar në pozicionin

<sup>3</sup>Neni 165 i ligjit nr. 96/2016, “Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë: (a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës; (b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim; (c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit, të parashikuara në gjerat ‘a’ dhe ‘b’, të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit”.

e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas parashikimeve ligjore. Trupi gjykues, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, ka vlerësuar ta pyesë atë se pse ka aplikuar kur dukej se ka qenë në kushtet e mospërmbushjes në mënyrë kumulative të kriterit ligjor.

**36.** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se për periudhën nëntor 2011 – prill 2016 është angazhuar në dhënien e asistencës juridike në mënyrë vullnetare pa pagesë pranë \*\*\* dhe për 6 vjet ka paguar detyrimet shoqërore dhe shëndetësore. Sipas subjektit, kjo periudhë gjatë së cilës është angazhuar në dhënie asistence pa pagesë përkon me periudhën kohore prej 11 vitesh në ushtrimin e profesionit të juristit dhe është brenda kuadrit ligjor të përcaktuar në kriteret e vendosura nga neni 6/3 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**36.1** Në vlerësim të trupit gjykues, eksperiencia e punës së znj. Jurida Bajraktari nuk është në harmoni me kërkesat ligjore që kërkojnë përvojë profesionale si jurist në: organet e sistemit të drejtësisë; funksione publike në administratën e Kuvendit; administratën e institucionit të Presidentit; aparatin e Këshillit të Ministrave; ministri dhe institucione qendrore të pavarura; Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë; prokurorinë, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Trupi gjykues çmon edhe këto mangësi, pjesë e mungesës së duhur të formimit profesional dhe aftësive të saj për të identifikuar konfliktin e normave apo aftësia për të analizuar jurisprudencën dhe, më tej, aftësisë për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim.

**37.** Trupi gjykues mbajti në konsideratë gjatë vlerësimit të subjektit edhe qëndrimin dhe shpjegimet e dhëna prej saj gjatë procesit administrativ dhe në seancën dëgjimore publike. Po ashtu, mbajti në konsideratë edhe qëndrimet e saj mbi etikën në punë, referuar një konflikti mes saj dhe gjyqtares pranë së cilës kishte ushtruar detyrën, duke arritur në përfundimin se në vlerësimin tërësor të rrethanave të paraqitura trupi gjykues çmon se, pavarësisht rrethanave në dukje konfliktuale mes subjektit të rivlerësimit dhe gjyqtares pranë së cilës ushtronte detyrën, duhet evituar çdo fjalor joetik<sup>4</sup>, pavarësisht rrethanës që e dikton, pasi duhet demonstruar sjellje që i shërben figurës së magjistratit, si dhe në zbatim të Kodit të Etikës në administratë komunikimi duhet të jetë etik, i qartë dhe i rregullt. Etika në punë lidhet edhe me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në ushtrimin e detyrës dhe është tregues i vlerësimit të punës, prandaj duhet treguar kujdes i veçantë.

## KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara dhe në rezultatet e hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj lidhur me kriterin e aftësive profesionale, konstaton për subjektin e rivlerësimit “*me mangësi*”. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk tregon aftësi profesionale si aftësia për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parime të përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. Një kriter i vlerësuar me mangësi është edhe angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion dhe aftësia profesionale dhe angazhimi profesional.

Lidhur me përvojën profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe emërimin në detyrën e ndihmësit ligjor, trupi gjykues çmon se arsyetimi dhe gjykimi që subjekti i ka bërë kriterëve, si dhe vlerësimi në raport me jetëshkrimin personal, reflekton mangësi. Subjekti ka aplikuar për një pozicion pune që duket se nuk përputhet me përvojën e saj dhe këtë fakt ajo nuk ka

<sup>4</sup>Shihni vendimin nr. 171, datë 22.4.2021, “Për miratimin e Kodit të Etikës Gjyqësore” seksioni Ç, Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërbajtje.

qenë në gjendje ta arsyetojë. Trupi gjykues e konsideron këtë fakt në këtë mënyrë, pa dashur të ndërhyjë në gjykimin e komitetit *ad hoc*. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se mungesat e konstatuara në vlerësimin profesional për subjektin e rivlerësimit mund të jenë ndikuar edhe nga eksperiencia e saj e mëparshme, e cila jo më kot ka qenë kriter ligjor kualifikues. Një jurist i aftë duhet të jetë në gjendje të vlerësojë faktin nëse përmbush apo jo kriteret formale të shpallura dhe të arsyetojë bindshëm se si e ka gjetur veten brenda tyre.

Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti ka shfaqur një nivel të dobët arsyetimi dhe gjykimi e me mangësi.

Trupi gjykues i Komisionit, duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, vlerëson se ato janë të tilla që të mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pas diskutimeve në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në pikat 1 dhe 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, nenit 44/b, germës “b”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Pezullimin nga detyra të znj. Jurida Bajraktari, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit për ndihmës ligjor, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit, bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesve ndërkombëtarë, Shkollës së Magjistraturës, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ester Arapi*